

Përleshje masive me armë e thika, arrestohen 6 persona, lëndohen 3 të tjerë

🕒 11:13 | 21 Nentor 2020



Një përleshje në mes 9 personave ka ndodhur ditën e djeshme në Deçan.

Sipas Policisë së Kosovës në këtë përleshje janë përdorur mjete të forta, thika e arma e zjarrit.

“Fsh. Gramaqel, Deçan, 19.11.2020 – 20:25. Është raportuar se ka ndodhë një rrahje mes nëntë personave të dyshuar meshkuj kosovarë. Gjatë rrahjes janë përdorë mjete të forta, thika dhe dyshohet të jetë përdorë arma e zjarrit”, ka njoftuar PK-ja.


Nga ky incident të lënduar kanë mbetur 3 persona teksa 6 të tjerë janë dërguar në mbajtje.

“Tre persona kanë marrë lëndime të lehta trupore dhe kanë pranuar tretman mjekësor. Me urdhër të prokurorit gjashtë të dyshuar janë arrestuar dhe dërguar në mbajtje ndërsa tre janë liruar në procedurë të rregullt”, është bërë e ditur tutje në njoftim.

SHPËRNDAJE



Lajme të fundit




18:45 | 21 Nentor 2020

Loredana jep detaje rreth dokumentarit për jetën e saj, pjesë e tij edhe Mozzik



18:41 | 21 Nentor 2020

Telekomi në krizë – probleme edhe me rrjetin e telekomunikim



18:33 | 21 Nentor 2020

Policët në Pejë lëvizin lirshëm pa maska, qytetarët për këtë po dënohen masivisht



18:28 | 21 Nentor 2020

Torino konfirmon rastin e katërt me COVID-19 në skuadër



Qeveria afgane fajëson talibanët për sulmet me raketa në Kabul



Situatë alarmante në Itali: 692 të vdekur e mbi 34 mijë raste të reja me COVID-19



Trump nuk jep shenja se do ta pranojë humbjen, thotë se zgjedhjet u manipuluan



Macron: Cila është doktrina ime për një Evropë sovrane, dhe me peshë në botë



Samiti virtual i G20-s: Një mikpritës problematik

